



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
MINISTRI

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE
KOMISIONERI

Nr. 5242/3 Prot
Tiranë, më 21 . 01 . 2026

Nr. 252/1 Prot
Tiranë, më 02 . 2 . 2026

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 13 "PËR Dt. 21.01.2026

MËNYRËN E ORGANIZIMIT, ADMINISTRIMIT, AFATIT TË RUAJTJES,
KONTROLLIN DHE FSHIRJEN E TË DHËNAVE TË MBLEDHURA NË RASTET E
NDALIMIT TË PËRKOHSHËM POLICOR, NDALIMIT DHE ARRESTIMIT TË
PERSONAVE"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 3, të nenit 36, të ligjit nr. 82/2024 "Për Policinë e Shtetit" dhe ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", Ministri i Punëve të Brendshme dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

UDHËZOJNË:

Neni 1
Objekti

Ky Udhëzim ka për qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave për administrimin, përpunimin, ruajtjen, kontrollin dhe fshirjen e të dhënave personale të mbledhura nga strukturat e Policisë së Shtetit, gjatë ndalimit të përkohshëm policor, ndalimit dhe arrestimit të personit.

Neni 2
Përkufizime

1. Në këtë udhëzim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- "përpunimi i të dhënave personale për qëllime policore" është përpunimi i të dhënave personale nga Policia e Shtetit, me qëllim ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, parandalimin dhe zbulimin e veprave penale, mbrojtjen dhe parandalimin e kërcënimeve për sigurinë publike duke përfshirë operacionet policore (që kryhen me të dhëna personale ose grupe të të dhënave

personale, me mjete automatike ose jo), si mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, deklarimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njehësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi.

b) *“ndalimi i përkohshëm policor”* është dërgimi i shtetasit në ambientet e policisë, në institucionet shëndetësore, në qendrat e rehabilitimit, te kujdestari ligjor ose personi përgjegjës, në institucionin epror ose në institucionet e tjera me ose pa vullnetin e tij, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 19, të Ligjit 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, (në vijim ligji nr. 82/2024).

c) *“ndalim”* ka të njëjtin kuptim me atë të parashikuar në nenin 253, të Kodit të Procedurës Penale.

d) *“arrestim”* ka të njëjtin kuptim me atë të parashikuar në nenin 251, të Kodit të Procedurës Penale.

e) *“arrestim i përkohshëm”* ka të njëjtin kuptim me atë të parashikuar në nenin 495, të Kodit të Procedurës Penale.

f) *“profilizimi i të dhënave”* i referohet përpunimit të automatizuar të të dhënave personale për të vlerësuar karakteristikat e një individi, siç janë sjellja, preferencat ose vendndodhja e tij, për të parashikuar ose analizuar aspekte të personalitetit ose performancës së tij. Kjo përfshin përdorimin e të dhënave për të marrë vendime që ndikojnë ndjeshëm tek jeta private e individit.

2. Terma të tjerë, të përdorur në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me ato të nenit 3, të Ligjit nr. 82/2024 dhe nenit 5, të Ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, (në vijim ligjit 124/2024).

Neni 3

Fushëveprimi

1. Ky udhëzim zbatohet nga të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit dhe të gjithë punonjësit e policisë gjyqësore të përfshirë në proceset e ndalimit të përkohshëm, ndalimit dhe arrestimit të personave.
2. Ky udhëzim aplikohet për të gjithë sistemet manuale dhe elektronike të Policisë së Shtetit, që përdoren për kryerjen e procedurave policore në rastet e ndalimit të përkohshëm policor, ndalimit, arrestimit dhe arrestimit të përkohshëm.

Neni 4

Parime të përgjithshme

Përpunimi i të dhënave personale nga Policia e Shtetit kryhet në përputhje me parimet e përcaktuara në ligjin nr. 124/2024, duke garantuar respektimin e të drejtave të individit dhe qëllimin e ligjshëm të veprimtarisë policore.

Neni 5

Qëllimi i përpunimit të të dhënave

Policia e Shtetit, përpunon të dhënat personale me qëllim dokumentimin ligjor të veprimeve policore ndaj personave të ndaluar përkohësisht, të ndaluar ose arrestuar. Në çdo rast, përpunohen të dhëna të kësaj kategorie subjektsh për të garantuar rendin, sigurinë publike dhe kombëtare.

Neni 6
Të drejtat e subjekteve të të dhënave

1. Subjektet, të dhënat personale të të cilëve përpunohen nga Policia e Shtetit, gëzojnë të drejtën për informim, akses, korrigjim, fshirje ose kufizim të përpunimit, si dhe të drejtën për rishikimin e përgjigjes sipas ligjit nr. 124/2024.
2. Kufizimi plotësisht apo pjesërisht nga këto të drejta, parashikohet vetëm në zbatim të neneve 55-57, të ligjit nr. 124/2024 dhe për aq kohë sa kjo përbën një masë proporcionale për rastin.

Neni 7
Masat e sigurisë

1. Policia e Shtetit ndërmerr masa të përshtatshme sigurie teknike dhe organizative¹ për të siguruar që çdo e dhënë që përpunohet të kryhet në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 124/2024. Të dhënat personale ruhen në sisteme elektronike të sigurta dhe të aksesueshme vetëm nga personeli i autorizuar në Policinë e Shtetit.
2. Policia e Shtetit në çdo rast siguron përdorimin e teknologjive informative, që garantojnë integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave personale që përpunohen.
3. Policia e Shtetit kryen vlerësimin e ndikimit në mbrojtjen e të dhënave, kur aktivitetet e përpunimit të të dhënave kanë të ngjarë të rezultojnë në një rrezik të lartë për të drejtat dhe liritë themelore të subjekteve të të dhënave. Ky vlerësim i ndikimit, përfshinë identifikimin e rreziqeve dhe përcaktimin e masave që duhen ndërmarrë për zbutjen e tyre².
4. Në rastin e përdorimit të sistemeve apo pajisjeve të ndryshme teknologjike, ndërmerren masa për mbrojtjen e të dhënave në projektim dhe në mënyrë të paracaktuar, duke e integruar atë në teknologji që në momentin që ajo krijohet.
5. Në zbatim të nenit 61, të ligjit nr. 124/2024, Policia e Shtetit mban dokumentacionin e veprimtarive të përpunimit, në të cilin përfshihen, nëse ka, edhe informacionet rreth përdorimit të profilizimit.
6. Kur konstatohet një rast cenimi i të dhënave personale, Policia e Shtetit njofton, Zyrën e Komisionerit si dhe subjektin e të dhënave në fjalë për shkeljen e tyre, në zbatim të ligjit.
7. Të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit, që i nënshtrohen këtij udhëzimi janë të detyruar të mbajnë konfidenciale të dhënat e përpunuara gjatë ushtrimit të funksioneve edhe pas përfundimit të tyre.

Neni 8
Kategoritë e të dhënave personale të përpunuara gjatë veprimtarisë policore

1. Të dhënat personale të mbledhura me qëllim identifikimin e personit gjatë procesit të ndalimit të përkohshëm policor, ndalimit dhe arrestimit përfshijnë të gjitha kategoritë e të dhënave, të parashikuara në nenin 36, të ligjit nr. 82/2024.
2. Këto të dhëna mbledhen dhe përpunohen duke respektuar parimet dhe parashikimet e ligjit nr. 124/2024.

¹ Këto masa duhet të jenë të dokumentuara, të jenë specifike dhe proporcionale me kategorinë të dhënave që përpunohen dhe mënyrën e përpunimit, si dhe të korrespondojnë masat e parashikuara me ato që zbatohen në praktikë.

² Vlerësimi i ndikimit në mbrojtjen e të dhënave parashikohet në nenin 64, të Ligjit.

3. Të dhënat e administruara nga Policia e Shtetit regjistrohen në bankën qendrore për regjistrimin e të dhënave.

Neni 9

Kategoritë e të dhënave sensitive

1. Gjatë procesit të ndalimit të përkohshëm policor, përpunohen të dhëna sensitive.
2. Kategoritë e të dhënave sensitive që përpunohen për personat e ndaluar apo arrestuar, nga punonjësi i policisë për qëllim identifikimi, janë:
 - a) përshkrimi i pamjes së personit, përfshirë shenja të veçanta;
 - b) shenjat e gjurmëve të gishtave dhe të pëllëmbëve të duarve;
 - c) fotografi, një pamje ballore dhe një profil;
 - ç) mostra të zërit të të arrestuarit apo të të ndaluarit;
 - d) kampionë biologjikë, me qëllim përcaktimin e profilit të ADN-së, pasi prokurori të ketë marrë pëlqimin e personit, sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

Neni 10

Afatet e ruajtjes së të dhënave

1. Të dhënat personale ruhen vetëm për periudhën e nevojshme për qëllimet për të cilat janë mbledhur dhe më pas, fshihen ose asgjësohen në përputhje me ligjin nr. 124/2024.
2. Të dhënat personale për personat e ndaluar përkohësisht, nuk mbahen më shumë se gjashtë muaj, me përjashtim të rastit kur ka arsye të përligjur për mbajtjen e tyre, bazuar në fakte që tregojnë se ato janë të nevojshme për qëllime të një hetimi në proces ose një procesi gjyqësor.
3. Të dhënat personale për personat e ndaluar ose arrestuar, mbahen 5 vjet, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj.
4. Të dhënat sensitive për personat e ndaluar ose arrestuar ruhen dhe asgjësohen në përputhje me parashikimet ligjore të detyrueshme për zbatim nga Policia e Shtetit. Administrimi i tyre realizohet në mënyrë të posaçme, sipas rregullave të parashikuara në ligjin nr. 124/2024.
5. Në rast se të dhënat personale të personave të ndaluar përkohësisht, të ndaluar dhe arrestuar në ambientet e Policisë së Shtetit, mbahen për më shumë se afatet e specifikuara më sipër, për shkak se janë të nevojshme për qëllime të një hetimi penal në proces ose procesi gjyqësor, do të aplikohen të njëjtat rregulla për afatet e rishikimit të përcaktuara në këtë udhëzim.

Neni 11

Rishikimi

1. Nëse të dhënat personale të përfshira në një proces rishikimi vlerësohen për t'u mbajtur me qëllim parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale të ndryshme me dënime maksimale të ndryshme, periudha e rishikimit do t'i korrespondojë masës maksimale të dënimit të parashikuar për veprën penale më të rëndë, sipas afateve të mëposhtme:
 - a) dy vjet, për të dhënat personale në lidhje me vepra penale, dënimi për kryerjen e të cilave shkon deri në dy vjet burgim;
 - b) tre vjet, për të dhënat personale në lidhje me veprat penale, dënimi për kryerjen e të cilave shkon deri në 10 vjet burgim;

- c) pesë vjet, për të dhënat personale në lidhje me veprat penale, dënimi për kryerjen e të cilave shkon mbi 10 vjet burgim.
2. Nëse pas rishikimit të kohës së mbajtjes të të dhënave, vendoset që ato të vazhdohen të mbahen në sistemet elektronike, atëherë fillon një periudhë e re rishikimi.
 3. Vendimi për vazhdimin e mbajtjes së të dhënave regjistrohet në një regjistër të posaçëm për qëllimin e vetëm të kontrollit dhe verifikimit të ligjshmërisë së tij sipas legjislacionit në fuqi, dhe rregullat e përcaktuara në këtë udhëzim.
 4. Të dhënat e ruajtura në regjistër përmbajnë, të paktën, numrin, datën dhe orën e marrjes së vendimit, arsyen për mbajtjen e të dhënave, si dhe përcaktimin e qartë të identitetit të punonjësit të policisë që ka marrë vendimin.
 5. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit identifikon në çdo rast strukturën përgjegjëse të policisë që do të kryejë vlerësimin dhe që do të marrë vendimin për vazhdimin e mbajtjes apo të fshirjes së të dhënave personale të përpunuara.
 6. Nëse koha e mbajtjes së të dhënave personale rishikohet dy herë, pas këtij afati, vendimi për rishikim miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë ose Drejtori Rajonal për Kufirin dhe Migracionin, përveç rasteve kur aplikohet një nga kushtet e mëposhtme:
 - a) kur të dhënat për personin janë përditësuar ose konsultuar (aksesuar) vazhdimisht, veçanërisht, nëse informacione të reja janë shtuar gjatë gjashtë muajve të fundit;
 - b) kur ka të dhëna të qarta, bazuar në fakte, se personi i përket ose është i lidhur ngushtë me një organizatë kriminale ose terroriste;
 - c) kur, sipas studimeve përkatëse shkencore apo statistikore, lloji i krimit, lidhur me të dhënat e mbajtura mbi personin, ka shumë të ngjarë që të kryhet sërish prej tij.
 7. Periudha e rishikimit të ardhshëm ndërpritet gjatë kohës që personi kryen dënimin me burgim dhe fillon sërish me daljen e tij nga burgju.

Neni 12

Kriteret për rishikimin e domosdoshmërisë për mbajtjen e të dhënave personale

1. Për përcaktimin e domosdoshmërisë për mbajtjen e të dhënave personale, merren parasysh kriteret e mëposhtme:
 - a) mosha e subjektit të të dhënave, duke treguar kujdes të veçantë për të mitur e të moshuarit;
 - b) shuarja e dënimit, që nënkupton rastin kur një person e ka kryer dënimin me burgim dhe ndërkohë edhe periudha e parë e rishikimit ka kaluar, të dhënat personale të tij fshihen, përveç rasteve kur ekzistojnë prova që vërtetojnë se ato janë të domosdoshme për hetime të tjera në proces. Në rastin e të dhënave sensitive, ato fshihen, përveç se kur janë absolutisht të nevojshme për tu mbajtur për shkak të hetimeve të tjera në proces.
 - c) për vendimet e gjykatës, veçanërisht, vendimet e saj për shpalljen e pafajësisë në lidhje me vepra penale të veçanta, i gjithë informacioni në lidhje me to duhet të fshihet, përveç rasteve kur ekzistojnë prova që vërtetojnë se ato janë të domosdoshme për hetime të tjera në proces.
 - ç) në rastin e të dhënave sensitive, ato fshihen, përveç se kur janë absolutisht të nevojshme për tu mbajtur për shkak të hetimeve të tjera në proces. I njëjti kusht mund të aplikohet edhe për rastet e amnistisë apo të rehabilitimit.

Neni 13

Sinjalizimi

1. Në sistemin elektronik të Policisë së Shtetit, lëshohet një sinjal (alert) dy muaj para afatit të rishikimit të kohës së mbajtjes të të dhënave personale.
2. Nëse është përmbushur afati dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim për rishikimin e kohës së mbajtjes të të dhënave nga struktura përgjegjëse e policisë, atëherë këto të dhëna fshihen.
3. Departamenti për Teknologjinë e Informacionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Merr masa për modifikimin apo ridizenjimin e sistemeve me qëllim zbatimin e afateve të ruajtjes apo anonimizimin e të dhënave personale dhe për fshirjen e këtyre të dhënave ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit të Informacionit dhe Mbrojtjes së të Dhënave, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Neni 14

Regjistrimi dhe mbikëqyrja

1. Qëllimi për mbajtjen e regjistrit të përmendur në pikën 3, të nenit 11 të këtij udhëzimi, është krijimi i një mekanizmi kontrolli të përshtatshëm për të kryer verifikimin e ligjshmërisë së vendimit për vazhdimin e mbajtjes së të dhënave personale.
2. Të dhënat që përmban ky regjistër do të fshihen në të njëjtën kohë me të dhënat personale të lidhura me to, përveç se kur janë të nevojshme për kontrole ose procese gjyqësore në vazhdim.
3. Kontrolli i regjistrit bëhet në mënyrë periodike nga Drejtoria e Menaxhimit të Informacionit dhe Mbrojtjes së të Dhënave për të verifikuar pajtueshmërinë me rregullat për kohën e mbajtjes së të dhënave, si dhe me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale.
4. Të dhënat e regjistrit do të vihen në dispozicion të autoriteteve me kompetenca mbikëqyrëse, brenda dhe jashtë strukturës së Policisë së Shtetit.
5. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë inspektimeve kryesisht dhe atyre me bazë ankese nga subjektet e të dhënave, përdorë informacionin që përmban regjistri, gjatë ushtrimit të kompetencave të tij mbikëqyrëse, në mënyrë që të sigurohet që përpunimi i të dhënave personale nga ana e policisë është kryer në mënyrë të ligjshme.

Neni 15

Kontrolli dhe monitorimi

1. Komisioneri për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron respektimin e rregullave të përcaktuara në këtë udhëzim.
2. Çdo shkelje e dispozitave duhet të raportohet dhe të trajtohet në përputhje me ligjin.

Neni 16

Sanksionet

Punonjësit e Policisë së Shtetit që shkelin dispozitat e këtij udhëzimi, mbajnë përgjegjësi administrative dhe/ose penale, sipas legjisllacionit në fuqi.

Neni 17
Konfidencialiteti

Të gjitha strukturat policore, punonjësit që zbatojnë këtë udhëzim, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë e të dhënave të përpunuara gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, edhe pas përfundimit të funksionit.

Neni 18
Zbatimi

Ngarkohen, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe strukturat e saj për zbatimin e këtij urdhëzimi.

Neni 19
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në fletoren zyrtare.

PËR
MINISTRINË E PUNËVE TË BRENDSHME

MINISTRI

ALBAN KOCIU



PËR
KOMISIONERIN PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

KOMISIONERI

BESNIK DERVISHI

